



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/ I 73-8 Prot.
Nr. Dok. 202503147/8

Tiranë 18.12.2025

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave urgjente për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes sociale në vlerësim të kushteve social-ekonomike, për Znj. L. I.*

Drejtuar: **BASHKISË HIMARË**

Për dijeni: **PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

**DREJTORISË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR
VLORE**

Të nderuar,

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Siç jeni në dijeni nga komunikimet e mëparshme institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13, të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e

Popullit”, i ndryshuar, nisur nga lajmi i publikuar në median online me titull: “*L. kërkon ndihmë, prej dy muajsh fle në shezlonget e Borshit*”¹, ka filluar me nismën e tij, ndjekjen e kësaj çështjeje.

Në lajmin e publikuar morëm informacion mbi një grua 51-vjeçare, të quajtur L., e cila prej dy muajsh është e detyruar të flejë jashtë, në shezlongë, pasi është përzënë nga familja e saj. E vetme, pa mbështetje dhe pa asnjë të ardhur, ajo ka mbetur pa strehë, ndërkohë që nëna, dy vëllezërit dhe motra nuk e kanë pranuar për shkak të varfërisë së skajshme. Gjendja e saj shëndetësore është rënduar më tej, pasi është infektuar dhe nuk ka mundësi të blejë as ilaçet bazë. Për ushqim varet vetëm nga ndihma e rastësishme e qytetarëve.

Pas publikimit të lajmit, u kontaktua personalisht qytetarja në numrin e saj, të vendosur në dispozicion nga media, për të mesuar më shumë rreth fakteve dhe për të marrë të dhënat personale. Qytetarja L. I., e lindur në Borsh, ka konfirmuar se gjendja e saj është shumë e vështirë. Ajo ndodhej në Qeparo, pranë një plazhi të përdorur nga kamperë, ku po përpiqet të qëndrojë pa asnjë mbrojtje të sigurt.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Avokati i Popullit, pasi është njohur me problematikën e sipërcituar, vendosi marrjen në shqyrtim të saj dhe nisjen e hetimit administrativ, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar².

Në kuadër të hetimit administrativ, të orientuar për gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë e të qëndrueshme të rastit, Avokati i Popullit, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor³, i ka kërkuar Bashkisë Himarë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Vlorë dhe Bashkisë Sarandë, informacion dhe shpjegime, lidhur me situatën social ekonomike të qytetares dhe mundësitë për ta ndihmuar atë në adresimin e problematikës së evidentuar.

Në përgjigje të kërkesës për informacion dhe shpjegime⁴, Bashkia Himarë informon sa vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj nr. K1/1 73-2, datë 29.07.2025, protokolluar në institucionin tonë me nr. 5971 prot., datë 31.07.2025, lidhur me kërkesën për marrjen e masave në lidhje me rastin e znj. L., të publikuar në rrjetet sociale nga media online "JOQ", ju informojmë si më poshtë: Rasti i znj. L. I. është referuar për herë të parë pranë institucionit tonë më datë 27.01.2025, nëpërmjet një kallëzimi të paraqitur në Komisariatit e Policisë Himarë nga nëna e saj, znj. B. I. Kjo e fundit ka kërkuar lëshimin e një urdhri mbrojtjeje, duke deklaruar se ndihej e kërcënuar nga vajza e saj, e cila ushtronte dhunë ndaj saj dhe dy fëmijëve të saj me probleme të shëndetit mendor. Znj. B. ka bërë me dije se pas divorcit, vajza e saj L. mbeti pa strehë dhe u rikthye në banesën e prindërve në fshatin Borsh, gjë që nuk u prit mirë nga familjarët. Si pasojë, me vendimin nr. Regj. Themeltar 16(21017- 00145-61-2025), datë 29.01.2025, Gjykata e Shkallës së

¹ Lajmi i publikuar në median online “JOQ”, në platformën Instagram, më datë 11.07.2025; <https://www.instagram.com/p/DL9kHXFMkJ/?igsh=NDYyMnNyOTZhMG9y>

² Neni 13, paragrafi i parë: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”.

³ Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe neni 19 pika b, Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”.

⁴ Shkresa nr. K1/I73-2 prot., datë 29.07.2025 “Kërkesë për shpjegime” Bashkisë Himarë.;

Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë vendosi lëshimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje në favor të znj. B. I.. Më datë 29.04.2025, znj. L. I. ka paraqitur një kërkesë pranë Bashkisë Himarë për përfitim nga programet e strehimit. Në përgjigje të saj, është informuar se aktualisht Bashkia nuk disponon banesa sociale dhe nuk ka në funksion programe për bonus qiraje. E vetmja mundësi që ofrohet është programi për restaurimin e pjesshëm të banesave shumë të amortizuara.

Gjithashtu, sqarojmë se Bashkia Himarë nuk ka në dispozicion strehëza emergjente apo bashkëpunime me organizata jofitimprurëse që ofrojnë strehim për individë në situatë rruge apo nevoje. Në këto kushte, është e pamundur të ofrohet mbështetje e menjëhershme për rastin konkret. Megjithatë, znj. L. është kontaktuar nga administratorja sociale e njësisë përkatëse dhe është informuar për mundësinë e përfitimit të ndihmës ekonomike. Për këtë qëllim, i është shpjeguar se fillimisht duhet të realizojë procedurën e ndarjes nga trangu familjar, për të mundësuar aplikimin e mëvonshëm në skemën e ndihmës ekonomike.

Në përgjigje të kërkesës për informacion dhe shpjegime⁵, DRSHTSH Vlorë informon sa vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. K1/173-3 Prot. Datë 29.07.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1519 Prot. Datë 31.07. 2025 lidhur me kërkesën për shpjegime për znj. L. I. mbi lajmin e publikuar në median online, ju bëjmë me dije se: Drejtoria Rajonale Vlorë e ka referuar rastin e znj. L. I. në Bashkinë Himarë.

Pas verifikimeve të kryera nga Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë në Bashkinë Himarë, na kanë venë djeni për situatën social-ekonomike të qytetares si më poshtë vijon: "Në lidhje me lajmin e publikuar së fundmi në rrjetet sociale, konkretisht në faqen "JOQ Albania", ku është bërë publik rasti i një zonje e gjendur në kushtet e pastrehësisë në fshatin Borsh, Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, ju informojmë si më poshtë: Rasti i znj. L. I. është referuar për herë të parë pranë institucionit tonë më datë 27.01.2025, përmes një kallëzimi të depozituar në Komisariatit e Policisë Himarë nga nëna e saj, znj. B. I.. Kjo e fundit paraqiti një kërkesë për urdhër mbrojtjeje, duke deklaruar se ndihej e kërcënuar nga vajza e saj, e cila ushtronte dhunë ndaj saj dhe ndaj dy fëmijëve të saj që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Znj. B. bëri me dije se pas divorcit nga bashkëshorti, vajza e saj L. mbeti pa strehë dhe u rikthye në familjen e origjinës në fshatin Borsh, çka nuk u mirëprit nga familjarët. Si rezultat, më datë 29.01.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin Nr. Regj. Themeltar 16(21017-00145-61-2025), vendosi lëshimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje në favor të znj. B. I.. Më datë 29.04.2025, znj. L. I. ka paraqitur pranë Bashkisë Himarë një kërkesë për strehim, duke kërkuar përfitim nga programet përkatëse të institucionit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Himarë e ka informuar se aktualisht nuk disponon banesa sociale apo programe për bonus qiraje. Institucioni ofron vetëm programin për restaurimin e pjesshëm të banesave shumë të amortizuara. Gjithashtu, sqarojmë se Bashkia Himarë nuk disponon streheza emergjente apo organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për individë në situatë rruge apo në nevojë. Në këto kushte, është e vështirë të ofrohet asistencë e drejtpërdrejtë për rastin në fjalë, për më tepër që nga vendimi gjykatës znj. L. I. rezulton me vendbanim në Bashkinë Sarandë."

Pas informacionit të Bashkisë Himarë, bashkëpunuam me Administratoren Shoqërore të Zyrës së Ndihmës Ekonomike të Njësisë Administrative Lukovë, Bashkia Himarë. Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreu V, neni 23,

⁵ Shkresa nr. K1/173-3 prot., datë 29.07.2025 "Kërkesë për shpjegime" DRSHTSH Vlorë.;

Administratorja Shoqërore ka për detyrë: a) të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike; b) të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

Administratorja Shoqërore pas komunikimit në telefon me qytetaren konstatoi se znj. L. I. jeton në një dhomë në Qeparo të cilën ja ka venë në dispozicion e afërmja e saj.

Gjithashtu pas identifikimit të rastit si familje në nevojë, u informua znj. L. I. se nga data 01-10 Gusht 2025 mund të paraqitet pranë Njesisë Administrative Lukovë, për të aplikuar për Ndihmë Ekonomike si familje në nevojë.

Në vijim, për të marrë të dhëna të mëtejshme lidhur me informacionin e përcjellë nga DRSHTSH Vlorë ku cilësohet se qytetarja është banore e Bashkisë Sarandë, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi shpjegime⁶ nga Bashkia Sarandë, e cila përcolli informacionin, si vijon:

Lidhur me rastin e Znj. L. I. referuar nga JU, ju bëjmë me dije se rasti na është referuar më herët edhe nga Sherbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale, Vlorë. Ne verifikuam pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Sarandë nëse në këtë bashki rezulton të ketë vendbanimin ndonjë person me emrin L. I. dhe përgjigja ishte se nuk ka person me këtë emër në Bashkinë Sarandë, por rezulton një i tillë në Borsh, Bashkia Himarë.

Në Bashkinë Sarandë nuk ka streha për të pastrehët kurse shërbimet e tjera si Ndihma ekonomike dhe ndihmë nga programet e strehimit ofrohen vetëm për banuesit e Bashkisë Sarandë, pasi edhe sistemet e aplikimit nuk pranojnë aplikime nga qytetarë të bashkive të tjera.

Konsiderata të Avokatit të Popullit.

Politikat për mbrojtjen sociale në Shqipëri mbështeten në objektivat sociale që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka njohur si detyra të shtetit për t'i siguruar çdo qytetari shqiptar, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike apo fetare, jetë dinjitoze dhe shërbime publike cilësore sa i përket sigurimit të ushqimit të nevojshëm, strehimit, shëndetit dhe arsimit. Përbushja e objektiveve sociale që Kushtetuta detyron për të arritur mbrojtje sociale të qëndrueshme për këdo, me fokus të varfërit dhe grupet e cënueshme, mbështeten në:

- 1) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (OKB)⁷;
- 2) Parimet e Axfordës së Kombeve të Bashkuara 2030⁸;
- 3) Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁹.

⁶ Email datë 26.08.2025 "Kërkesë për shpjegime" Bashkisë Sarandë.

⁷ Neni 1: të gjithë njerëzit linden të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta, neni 22: si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

⁸ Progresi drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë familjeve të varfëra dhe individëve në nevojë, ku një prej elementëve më të rëndësishëm të Qëllimit 1 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, është arritja e mbrojtjes sociale të qëndrueshme për këdo, me fokus të varfërit dhe grupet e cënueshme.

⁹ Neni 9, njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në objektivat sociale, thekson se kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj dhe kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj (neni 52). Neni 59, pika 1, gërma “b”, sanksionon të drejtën për strehim duke theksuar se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim.” Kjo dispozitë reflekton angazhimin e shtetit për të siguruar kushte minimale jetese për të gjithë qytetarët, përmes një mbështetjeje institucionale të drejtë dhe të barabartë. Gjithashtu, neni 15 i Kushtetutës përcakton qartë se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë “të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme”, duke vendosur kështu themelet e rendit juridik në vend. Kjo nënkupton se çdo individ, pa dallim, gëzon të njëjtat të drejta dhe është i mbrojtur nga çdo formë diskriminimi.

Strategjia për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj përbëjnë dokumentet kryesore politike që adresojnë varfërinë në mënyrë të integruar në Shqipëri. Strategjia përcakton si qëllim të parë zbutjen e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara. Kjo synohet të arrihet përmes mbështetjes me skema financiare dhe përfitime të përshtatshme, të përgjegjshme gjinore, transparente dhe të afta për t’u përballur me rreziqe e kriza. Një tjetër drejtim është zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme, cilësore dhe të përgjegjshme gjinore, si dhe avancimi i procesit të deinstitutionalizimit të kujdesit rezidencial, në partneritet të ngushtë me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë shoqërorë.¹⁰ Në këtë kuadër, mbulimi, mjaftueshmëria dhe gjithëpërfshirja e përfitimeve të mbrojtjes sociale janë treguesit kryesorë për matjen e performancës së sistemit.

Ligjvënësi ka vendosur mekanizmat ligjorë dhe mjetet proceduriale në dispozicion të bashkive/organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar që ato të vijnë në ndihmë të shtresave në nevojë. Legjislacioni i shërbimeve sociale në thelb synon plotësimin e nevojave të shtetasve dhe familjeve të varfra, sidomos kur kemi të bëjmë me familje/individë në nevojë për mbështetje, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës është i rëndësishëm, me qëllim garantimin e mbrojtjes sociale, për identifikimin e vlerësimin e çdo rasti.

Ligji Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore, synojnë të zbusin varfërinë dhe përjashtimin shoqëror duke krijuar mundësi integrimi nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e jetesës (neni 1, pika b), duke patur qëllim të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet (neni 2, pika a dhe b) nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre, si dhe mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale (neni 2, pika ç)¹¹.

¹⁰ VKM Nr. 152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”;

¹¹ Përveç procesit të mësipërm, Qeveria akordon 6 përqind të buxhetit të Ndihmës Ekonomike për pushtetin vendor në formën e grantit në bllok për të financuar aplikantë shtesë për skemën e Ndihmës Ekonomike, Njësitë e pushtetit vendor, si rezultat i

Në ligjin Nr. 22/2018 “Për strehimin social”¹², i ndryshuar dhe aktet nënligjore, vërehet një kapërcim i qenësishëm e cilësor në mënyrën se si perceptohet strehimi i përballueshëm e si adresohen grupet në nevojë. Ky ligj parashikon parimet për strehim të përshtatshëm¹³, kriteret që e klasifikojnë strehimin e përshtatshëm¹⁴, llojet e programeve të strehimit, ndërthurjen e tyre me shërbimet sociale, rolin e njërive të vetqeverisjes vendore dhe qendrore dhe kriteret për përfitim nga këto programe nga qytetarët në nevojë.¹⁵

Gjithashtu, ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe aktet nënligjore përcaktojnë detyrimet e bashkive për të ofruar shërbime emergjente, të përkohshme dhe afatgjata për individët në nevojë. Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.¹⁶

Sjellim në vëmendje se edhe ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3 përcakton: *“Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve”*.¹⁷ Është në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkive, që të sigurojnë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Ato vendosen në pozicion pro-aktiv në lidhje me ofrimin e mbështetjes sociale në mënyrë që t’u krijojnë qytetarëve mundësitë për një jetë të përshtatshme e dinjitoze. Bashkia duhet të sigurojnë mekanizmat ligjorë e financiarë për nxjerrjen e tyre nga mjerimi¹⁸.

Nisur nga sa më sipër, bashkia si institucioni në nivel lokal me afër qytetarëve, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale” dhe ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, kur vlerësohet e nevojshme nga strukturat e vlerësimit të nevojave dhe referimit, duhet të ndërmarrë një sërë masash konkrete për mbrojtjen dhe integrimin e individëve në situata të cënueshme, sikurse paraqitet situata e znj. I., duhet të sigurojë ndihmën e menjëhershme emergjente, duke garantuar mbështetje psiko-sociale, strehim, ushqim, veshmbathje dhe trajtim shëndetësor bazë, si dhe të mundësohet përfshirja në skemat kombëtare të mbrojtjes sociale.

decentralizimit fiskal dhe administrativ të Shqipërisë që filloi të zbatohet në vitin 2015, mund të akordojnë edhe fonde shtesë nga buxheti i tyre për të mbështetur këtë kategori qytetarësh (VKM nr.955, datë 7/12/2016 “Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, Udhezimi nr.5 datë 17/02/2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”), bazuar në rivlerësimin e kryer nga administratorët shoqërorë .

¹² ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023)

¹³ Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, nenet 3-10

¹⁴ Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Neni 4 “Parimet e strehimit të përshtatshëm”;

¹⁵ Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Neni 11, 12, 13;

¹⁶ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, Kreu II, Neni 6-25;

¹⁷ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3 përcakton: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”.

¹⁸ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kreu III, neni 8, 9; Kreu VII, nenet 21,21,23,24; Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 18, neni 69, pika 2.

Me referencë rastin konkret objekt trajtimi nga ana jonë, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se jemi përballë një situatë të mosofrimit të shërbimit publik nga Bashkia Himarë, ndaj qytetares në nevojë, por jo vetëm, të cilët duhet të mbështeten dhe të përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale dhe kujdesit shoqëror, sikurse parashikohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Bashkia Himarë duke mos u ofruar qytetarëve në nevojë shërbime jetike të kësaj natyre, vepron në kundërshtim me parimet themelore që rregullojnë ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve publike. Këto parime, të cilat kanë karakter detyrues për çdo organ publik, përfaqësojnë standarde bazë të shtetit të së drejtës dhe shtetit social, janë të sanksionuara qartë në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Ky kod u imponon të gjitha organeve të administratës publike, përfshirë organet e vetëqeverisjes vendore, detyrimin që ofrimi i shërbimeve të garantohet mbi bazën e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, barazisë përpara ligjit, proporcionalitetit dhe objektivitetit. Respektimi i këtyre parimeve nënkupton se asnjë qytetari nuk mund t'i mohohet qasja në shërbime për shkak të rrethanave të tij të veçanta apo të gjendjes socio-ekonomike, por përkundrazi, është detyrim i pushtetit vendor të sigurojë trajtim të barabartë, gjithëpërfshirës dhe në respekt të dinjitetit njerëzor.

Mosrespektimi i këtij detyrimi nga ana e Bashkisë Himarë përbën shkelje të dispozitave ligjore, dhe cënim të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe interesave legjitime të qytetarëve të grupeve vulnerabël, duke u mohuar atyre aksesin në shërbime jetike të kësaj natyre: të drejtën për strehim dhe mbështetje sociale. Kjo situatë, përveçse ngre shqetësime të natyrës juridike, evidenton edhe domosdoshmërinë për ndërhyrje urgjente të organeve përgjegjëse, në mënyrë që të garantohet respektimi i parimit të shtetit social dhe detyrimi kushtetues i institucioneve për mbrojtjen e shtresave në nevojë.

Po ashtu, nga informacionet dhe shpjegimet e përcjella pranë Avokatit të Popullit në kuadër të hetimit administrativ vërehet se nga Bashkia Himarë, në mungesë të qasjes për të dhënë një zgjidhje për rastin konkret, ka përpjekje për të anashkaluar përgjegjësitë e saj duke u shprehur se qytetarja është banore e Bashkisë Sarandë. Siç e kemi sqaruar në parashkrimin e përgjigjeve të administruara nga institucionet publike, kjo e fundit (Bashkia Sarandë) na ka informuar se ankuesja figuron në Borsh, Bashkia Himarë. Avokati i Popullit vlerëson se kjo qasje, e cila nuk ndeshet për herë të parë nga institucioni ynë, nuk është në përputhje me misionin e organeve vendore për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve. Në rastin konkret, edhe nëse (hipotetikisht) ankuesja do të ishte banore e Bashkisë Sarandë, do të duhet që të dy njësitë e vetëqeverisjes vendore të bashkëpunojnë për të sqaruar rastin dhe për të përqendruar burimet e tyre administrative në gjetjen e një zgjidhje për shqetësimin e qytetares, duke përfshirë edhe institucione të tjera që ofrojnë shërbime publike.

Në këtë kontekst, vlerësojmë se qasja ndaj qytetares në nevojë dhe jo vetëm, që duhet të ketë bashkia si organ kyç i pushtetit vendor, më afër qytetarit se çdo organ tjetër, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre, duhet të jetë e tillë që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta. Organi i pushtetit vendor duhet të reflektojë një sjellje e cila të mos jetë përjashtuese apo diskriminuese kundrejt grupeve të caktuara të qytetarëve të cilët kanë të drejta të barabarta, pavarësisht gjendjes apo përkatësisë ekonomike, sociale, kulturore, etnike, arsimore, etj. Bashkia duhet të mbështesë dhe të vërtetojë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe ka ndaj qytetarëve në këto raste të vështira humane.

Për të adresuar problematikën e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, institucionet e pushtetit vendor si institucionet përgjegjëse, duhet të garantojnë standardet më të

larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve bazuar në parimin e subsidiaritetit. Organet e qeverisjes vendore, përkundrejt ankuesve por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi duhet të garantojnë standardin e nevojshëm për qeverisje, garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe standartin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve

Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron me shumë vëmendje, masat e marra nga autoritetet shqiptare për kategoritë më të rrezikuara me qëllim garantimin e jetesës normale/ dinjitoze për shtresat në nevojë.

Mbështetja për sigurimin e të drejtave të njeriut, së bashku me mbrojtjen e anëtarëve më të prekshëm të komuniteteve tona nga një kërcënim ekzistencial, është një qëllim legjitim. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore.

Në këtë kuptim, përgjigja e institucioneve vendore përgjegjëse duhet të jetë urgjente, dhe e koordinuar dhe në mbështetje të sa më shumë kategorive në nevojë. Ofrimi i ndihmës konkrete dhe i mjeteve bazë të jetesës, për të përballuar dhe kapërcyer sa më denjësisht situatat e vështira të individëve/ familjeve në nevojë, kërkojnë një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm si dhe garantim të shërbimeve bazë sociale.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të përmbushjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDON:

- ✓ *Marrjen e masave urgjente për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes sociale në vlerësim të kushteve social-ekonomike, për Znj. L. I., e vetmuar, pa asnjë të ardhur dhe e pastrehë, sipas legjislacionit në fuqi.*
- ✓ *Marrjen e masave urgjente për identifikimin e mundësive alternative për strehimin e ankueses në bashkëpunim me aktorë të tjerë që ofrojnë shërbime mbështetëse për gratë në nevojë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile që operojnë në Qarkun e Vlorës.*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Vilma SHURDHA

DV